



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.302/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar Ardita Haxhnikaj Demi, , dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.302/2026, të datës 16.03.2026, të parashtruar nga ankuesi S.B nga Gjilani, kundër organit të punësimit: Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “*transferim sipas ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.302/2026, e datës 16.03.2026, e parashtruar nga ankuesi S.B.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. APK 49/2026, i datës 27.02.2026, i U.D Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil S.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) më datë 16.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Nr. APK 49/2026, i datës 27.02.2026, i U.D Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, lidhur me transferimin e saj për shkak të ristrukturimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 19.03.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Agjencia Pyjore e Kosovës dhe (tutje APK), ndërsa, kjo e fundit, më datë 23.03.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 1356/2026 të datës 16.03.2026 të ankueses drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 249 të datës 27.02.206 të U.D Drejtorit të Departamentit për

Menaxhimin e Zyrtareve Publik në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Akt emërimit me numër 02-011-6903 të datës 01.01.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 2303.2026; Akt emërimit me numër 02-16-35391 të datës 30.03.2012; Vendimin me numër 2100 të datës 05.11.2025 për Themelimin e Komisionit për Ristrukturim në Agjencinë Pyjore të Kosovës; Raportin e punës dhe propozimet e Komisionit për ristrukturim për Agjencinë Pyjore të Kosovës të datës 02.02.2026; Emalin e datës 31.10.2025; Formularin e datës 31.10.2025 lidhur me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Asistent për Ruajtjen e Pyjeve;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton, Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 02-011-6903 të datës 19.01.2018, mbante pozitën Teknik i Pylltarisë, në Komunën e Gjilanit, ndërsa sipas Memorandumit për bashkëpunim me numër protokolli 5059 të datës 05.12.2023, është bërë bashkëpunimi mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal dhe Komunës së Gjilanit, me qëllim të transferimit nga Komuna e Gjilanit në Agjencinë Pyjore të Kosovës. të stafit të pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikeve të pylltarisë, përgjegjësve të njësive komunale etj., bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet tjera, si dhe mjetet përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjësit dhe detyrat e ndryshme pyjore.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr.227/ 2025,të datës 05.03.2025 ka miratuar Rregulloren (ZKM) nr.02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, me ç ‘rast procesi i organizimit të APK është pasuar me shuarje të pozitive, ndryshime në emërtime të pozitive përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kritereve të punës për pozita të caktuara.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me numër protokolli 2100 të datës 05.11.2025, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për APK, ku ky i fundit, më datë 02.02.2026 ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në APK, ashtu që ankuesi është propozuar të transferohet nga pozita Teknik i Pyjeve, në Asistent për Ruajtjen e Pyjeve profesional klasa-3. Në zbatim të propozimi të Komisionit të Ristrukturimit, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, më datë 27.02.2026, ka nxjerr Vendim me Nr. R. APK 49/2026 , me të cilin ankuesin e ka transferuar nga pozita Teknik i Pyjeve në pozitën Asistent për ruajtjen e pyjeve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e kundër Vendimit Nr. APK-493/2026, të datës 27.02.2026 të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, duke pretenduar se ka pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë pune në fushën e pylltarisë dhe mbrojtjen mjedisit pas asnjë mase disiplinore, i njëjti po ashtu pretendon se në muajin Prill- 2024 së bashku me disa zyrtar të tjerë janë sistemuar fizikisht për të punuar në objektet e Agjencisë Pyjore të Kosovës në drejtorinë regjionale në Gjilan dhe asnjëherë nuk ka pranuar ndonjë akt administrativ lidhur me këtë transferim, deri në muajin shkurt të vitit 2026 kur kamë pranuar vendimin me Nr.APK-493/2026 i cili përbënë aktin e parë administrativ formal lidhur me transferimin, cili akt përmban shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe ligjshmërisë se veprimeve të administratës publike. Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli kërkon që ti aprovohet ankesa duke e anuluar vendimin për transferimin e ankuesit si të paligjshëm, si dhe ta sistematizojë ankuesin në një pozitë ekuivalente brenda komunës së Gjilanit.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publikë, i cili përcakton se: 1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsyet e parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësueset e institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës... dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson së ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizmit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit mund të ketë ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës. Nisur nga ky fakt, kolegji në bazë të provave materiale të çështjes, konstaton se sipas memorandumit për Bashkëpunim, të datës 05.12.2023 stafi i pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikeve të pylltarisë, janë transferuar nga Komuna e Gjilanit në Agjencinë Pyjore me qëllim të bashkëpunimit për përmbushjen e objektivave të përgjithshme, kthimin e kompetencave në zbatim të Ligjit me Nr.08/L-137 për pyjet, e cila është e parapare me nenin 76 pika 7 të këtij ligji i cili përcakton se, neni 76 pika 7 Komunitat në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet ta kryejnë transferimin nga komunitat në Agjenci, të rojeve të pyllit, teknikeve të pylltarisë dhe përgjegjësve të njësive komunale, bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet e tjera, si dhe mjete përkatëse funksionale, që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore. Andaj duhet të theksohet se procesi i ristrukturimit nuk përbën mekanizëm për avancim automatik në detyrë, por një proces administrativ i bazuar në riorganizimin institucional dhe sistemin e stafit në përputhje me nevojat organizative dhe kriteret ligjore në fuqi dhe se me këtë rast komisioni nuk ka mundur të bëjë transferim në një institucion tjetër siç pretendon ankuesi.

Nëse i referohemi Rregullores (ZKM) nr.02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, si dhe emalit të datës 08.05.2026 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës, kolegji konstaton se titulli i pozitës Asistent për ruajtjen e pyjeve, si dhe pozita Teknik i pyjeve janë pozita me emërim të ndryshim por të njëjta sa i përket përshkrimit të detyrave të punës.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se ankuesi edhe para ristrukturimit ka mbajtur pozitë të kategorisë profesionale klasa profesionale 3, por edhe pas ristrukturimit pozita e tij është kategorizuar si pozitë e kategorisë profesionale klasa profesionale 3, Kolegji i Këshillit, vlerëson së ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës si rezultat i ristrukturimit, dhe meqenëse nuk ekzistojnë asnjëra nga arsyet ligjore për refuzim të transferimit siç parashihet me nenin 66 paragrafi 5 të Ligjit Nr.

08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin neni 63 paragrafi 3 i këtij ligji ku është ka përcaktuar se: “3. Transferimi i përkohshëm i nëpunës/it civil, është vendim i drejtueses/it më të lartë të institucionit dhe mund të refuzohet nga shërbyesja/ i civil në këto raste: 3.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë së njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunës/it civil”, Kolegji konstaton se nuk kanë mbështetje ligjore pretendimet ankimore të ankuesit si në ankesë.

Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve si më lartë, vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit në rastin e propozimin për sistemim të ankuesit ka vepruar në pajtim me 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenet 13, 14 dhe 15 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, dhe se Vendimi me numër protokolli 2109, i datës 05.11.2025 i Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Ministria e Punëve të Brendshme, është nxjerr në pajtim me nenin 66 paragrafi 3 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe po ashtu akti kontestuar përmban elementet të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, arsyetimi është dhënë në kuptim të raportit të komisionit të ristrukturimit, kështu që nuk gjejnë zbatim neni 64 dhe 65 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në rastin konkret të ankuesit, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë tërësisht të pabazuara.

Për sa më sipër, e duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS LËNDA, A.nr.302/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit S.B;
- Njesisë për Burime Njerëzore në APK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së